



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

**VENDIM**

**NR. 40, DATË 11.03.2021**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E ZGJIDHJES SË  
MOSMARRËVESHJEVE PËR SHFTYTËZIMIN E MULTIPLEKSIT”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, gërma “h” dhe nenit 63 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e rregullores “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për shfrytëzimin e multipleksit”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar:</b>	<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>
<b>Zëvendëskryetar:</b>	<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>
<b>Anëtarë:</b>	<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>
	<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**RREGULLORE**

**“PËR  
PROCEDURAT E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE PËR SHFRYTËZIMIN E  
MULTIPLEKSIT”**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, operatorit publik (RTSH) dhe OSHMA-ve lidhur me shfrytëzimin e multipleksit, rrjetit numerik.
2. AMA në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në zbatim të këtij akti nënligjor do të ketë për qëllim:
  - a. të ofrojë zgjidhje të shpejtë dhe të vendosur për mosmarrëveshjet midis OSHMA-ve, përfshirë transmetuesin publik;
  - b. të sigurojë që të drejtat e të gjitha palëve janë respektuar;
  - c. të kontribuojë në përmbushjen e të gjitha objektivave rregullatore;
  - d. të përkrahë investimet dhe konkurrencë efektive;
  - e. të mbajë në konsideratë dhe të respektojë kushtet e licencës së çdo operatori.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19, pika 1, gërma “h”, dhe neni 63.  
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.



### Neni 3 Objekti

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, RTSH-së dhe OSHMA-ve, lidhur me shfrytëzimin e multipleksit, rrjetit numerik të cilat lidhen me zbatimin e ligjit dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

### Neni 4 Parimet e shqyrtimit të mosmarrëveshjeve

1. AMA ushtron veprimtarinë administrative në kuadër të dispozitave të këtij akti nënligjor në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me OSHMA-të palë të procedimit administrativ të përfshirë në të.
2. AMA gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve në mënyrë që të garantojë konkurrencën e ndershme, do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:
  - A. Parimet e përgjithshme:
    - (i) Trajtim i drejtë dhe jo diskriminues i të gjithë subjekteve palë në procedimin administrativ.
    - (ii) Sigurimi i konfidencialitetit të informacionit, të dhënave dhe dokumenteve të siguruara gjatë procedimit administrativ për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve për shfrytëzimin e multipleksit, përveç rasteve të parashikuara me ligj.
    - (iii) Paanshmëria gjatë kryerjes së hetimit administrativ, vlerësimit të provave dhe dokumenteve të paraqitura dhe hartimit të akteve përkatëse.
    - (iv) Parandalimi i çfarëdolloj ndërhyrjeje, qoftë nga brenda, apo jashtë AMA-s, që mund të ndikojë në ndershmëri ose paanshmëri.
    - (v) Trajtimi me kujdes dhe përgjegjshmëri i secilës fazë të aktivitetit të shqyrtimit të mosmarrëveshjes.
    - (vi) Pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të procedimit administrativ pavarësisht parimeve të listuar në këtë nen.
  - B. Parimi i proporcionalitetit, sipas të cilit gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes kryen veprimet në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në të drejtat e palëve vetëm për aq sa është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të zgjidhjes së konfliktit.

### Neni 5 Përkufizime

Termet e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE për komunikimet elektronike, AVMSD (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë), që rregullojnë fushën.



Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ligj” nënkupton ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
2. “Kod” nënkupton ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
3. “Kërkues” nënkupton OSHMA-në, i cili paraqet kërkesë pranë AMA-s për zgjidhjen e një mosmarrëveshje.
4. “Pala Tjetër” nënkupton operatorin publik, (RTSH), mbajtësin e licencës kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ndaj të cilit mund të jetë ngritur mosmarrëveshja nga ana e kërkuesit.
5. “Palë të treta” nënkupton sipërmarrës ose palë të tjera, të cilat mund të jenë të lidhura me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
6. “Multipleks” është një pajisje teknike për vijimin e sinjaleve numerike dhe bashkimin e tyre në një fluks numerik të dhënash.
7. “Operatori i rrjetit numerik” është personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore dhe bashkimin e programeve numerike dhe shërbimeve shtesë të përfshira në fluksin numerik të të dhënave.
8. “Komisioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve”, është komisioni i ngritur nga Kryetari i AMA-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

## Neni 6

### Kushtet për shfrytëzimin e multipleksit

1. Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv janë të detyruar t’u japin akses në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, në jo më pak se 40 për qind të kapacitetit të multipleksit të tyre, OSHMA-ve që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe/ose licencë shërbimi programi audioviziv.
2. Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv ofrojnë aksesin për transmetim në rrjetin numerik, mbi bazën e marrëveshjeve tregtare me OSHMA-të. Tarifat për dhënien e aksesit për transmetim në rrjetin numerik duhet të orientohen në kosto.
3. AMA siguron që të gjitha shërbimet që u ofrohen OSHMA-ve, që zotërojnë licencë shërbimi programi audio dhe ose licencë shërbimi programi audioviziv, nga mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, bazohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese.
4. Mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv mund të refuzojnë kërkesën për përdorimin e infrastrukturës në rast se përdorimi i infrastrukturës është teknikisht i pamundur dhe pengon integritetin e sigurinë e rrjetit të operatorit. Refuzimi i kërkesës për përdorimin e infrastrukturës duhet të arsyetohet.
5. Në rastet kur përdorimi i infrastrukturës së mbajtësit së licencës kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, kërkon ndryshime në infrastrukturë, shpenzimet mbulohen nga pala, që kërkon përdorimin e infrastrukturës.



## Neni 7 Fusha e veprimit

1. Fusha e veprimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është ajo e parashikuar nga ligji që do të thotë mosmarrëveshjet lidhur me aksesin në rrjetin numerik, refuzimin për dhënien e aksesit, për karakteristikat teknike të transmetimit numerik, për standardet dhe cilësitë e transmetimit, tarifën e mbështetjes në rrjet numerik, ndërmjet mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv dhe OSHMA-ve. Në çdo rast duhet të mbahet parasysh se OSHMA duhet të respektojë standardet dhe parametrat e tyre teknike
2. AMA zgjidh mosmarrëveshjet midis RTSH dhe OSHMA-ve lidhur me karakteristikat teknike të transmetimit numerik, standardet, cilësinë e transmetimit, aksesin në rrjetin numerik dhe refuzimin për dhënien e aksesit.
3. AMA është e detyruar të zgjidhë mosmarrëveshjet lidhur midis mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv dhe OSHMA-ve. AMA nuk ka rol në trajtimin e formave të tjera të mosmarrëveshjeve dhe i refuzon këto mosmarrëveshje nëse i drejtohen.

## PROCEDURAT E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

### Neni 8 Komisioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

1. Komisioni i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve (KZM) është struktura *ad hoc* që ngrihet me urdhër të Kryetarit i kryesuar nga Zëvendëskryetari i AMA-s, ose çdo nëpunës tjetër i autorizuar prej Kryetarit dhe në përbërje të cilit ka anëtarë nga drejtoritë e AMA-s, referuar llojit të mosmarrëveshjes, objekt shqyrtimi.
2. KZM ngrihet brenda 10 ditësh nga depozitimi i ankesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
3. KZM asistohet nga sekretari, nëpunës i Drejtorisë Juridike dhe Licencave, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të tij.

### Neni 9 Paraqitja e ankimit

1. OSHMA dhe mbajtësit e licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimit numerik i drejtohen AMA-s, në rastin e mosmarrëveshjeve të lindura për mbështetjen në rrjet numerik
2. Ankesa paraqitet me shkrim, sipas Formularit të Ankimit dhe duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana mbi cënimin nga palët, të detyrimeve të parashikuara në nenin 63 të ligjit nr. 97/2013, dhe akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, që rregullojnë fushën, objekt i mosmarrëveshjes, si dhe të shoqërohet me dokumentacion argumentues. Kërkesa me shkrim mund të dërgohet edhe me mjete elektronike ose faks, në adresën zyrtare të AMA-s

## Neni 10 Njoftimi

1. KZM pas verifikimit paraprak të përmbushjes së kriterëve formale ligjore, të ankesës:
  - a) njofton palën kërkuese me shkrim brenda 8 ditëve se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës;
  - b) njofton palën kërkuese me shkrim për plotësimin e të metave lidhur me plotësimin e kriterëve formale ligjore, duke caktuar një afat të arsyeshëm, por jo më pak se 3 ditë. Në këtë rast, KZM ndihmon palën për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës.
2. KZM njofton brenda 8 ditëve palën ndaj të cilës është depozituar ankimi duke i përcjellë njoftim mbi kërkesën, duke e vënë në dijeni mbi parashtrimet e paraqitura nga pala kërkuese për t'i mundësuar palës tjetër paraqitjen e shpjegimeve dhe provave në lidhje me çështjen objekt të mosmarrëveshjes.
3. KZM kërkon nga secila palë në mosmarrëveshje të dhëna të plota dhe të sakta, duke respektuar kriterin e konfidencialitetit në lidhje me çështjen objekt të mosmarrëveshjes.

## Neni 11 E drejta për të paraqitur parashtrime

1. Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin parashtrime, mendime, shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes.
2. Palët, rezervojnë të drejtën për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar nga KZM.

## Neni 12 Prova dhe parashtrime

1. KZM:
  - a) shqyrton ankesën në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore;
  - b) shqyrton dhe vlerëson provat dhe parashtrimet e vëna në dispozicion nga palët;
  - c) çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjithë provave së bashku, si dhe në rezultatit tërësor;
  - d) mund t'i kërkojë palëve, të dhëna shtesë, apo personave të tretë në rast se provat dhe faktet e depozituara rezultojnë të pamjaftueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes;
  - e) zgjidh mosmarrëveshjet në mënyrë transparente, të shpejtë, objektive dhe jo diskriminuese.



2. KZM pasi shqyrton mosmarrëveshjen, provat shkresore të depozituara dhe pasi dëgjon pretendimet e palëve, përgatit relacionin përfundimtar që ia përcjell AMA-s për vendimarrje.

### Neni 13

#### Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit

1. KZM për çdo ankesë harton dhe mban një dosje, e cila përmban detyrimisht të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë procesit të shqyrtimit që nga fillimi i tij deri në përfundimin e procesit.
2. Në çdo mbledhje të KZM-së të zhvilluar për një ankesë të caktuar mbahet procesverbal, ku pasqyrohen data, vendi, rendi i ditës, anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejtuesi i saj, si dhe çështjet që janë diskutuar. Në fund të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

### Neni 14

#### Vendimi i AMA-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjes

1. Për mosmarrëveshjet objekt i kësaj rregulloreje, KZM paraqet pranë AMA-s, raport të hollësishëm duke përshkruar të gjitha fazat e ndjekura për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, paraqet pretendimet e palëve të interesuara, përmbledh historikun e procedimit dhe formulon një mendim paraprak për vendimin përfundimtar, duke përmbledhur arsyet ligjore dhe faktike që, sipas vlerësimit të KZM, e justifikojnë vendimin.
2. AMA, në vendimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bazohet në raportin analitik të përpiluar nga KZM për këtë qëllim sipas pikës 1, të këtij neni si dhe në vlerësimin e tij të pavarur për çështjen objekt të mosmarrëveshjes.

### Neni 15

#### Afati kohor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

AMA duhet të zgjidhë mosmarrëveshjet brenda një afati të përgjithshëm për veprime administrative të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Shqipërisë deri në 60 ditë. Në rast të një situate të veçantë, procedimi administrativ përfundon brenda 3 muajve pas përfundimit të situatës së veçantë.

### Neni 16

#### Kundërshtimi në gjykatë

Kundër vendimit të AMA-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, palët kanë të drejtë të ankohen në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**Neni 17**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga AMA.

**Neni 18**  
**Publikimi**

Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare të internetit [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al).



### Formulari i Ankimit

Informacion mbi formën e kërkuar për të paraqitur një mosmarrëveshje	Informacioni i kërkuar
<b>Lloji i informacionit</b>	
Të dhënat e kontaktit	Pala në mosmarrëveshje
Përcaktimi i mosmarrëveshjes	Përshkrim i detajuar dhe i qartë i mosmarrëveshjes. Kjo duhet të përmbajë përshkrimet për produktin/shërbimin në qoftë se është e rëndësishme.
Baza e mosmarrëveshjes	Baza specifike ligjore e mosmarrëveshjes, duke ju referuar klauzolave ligjore/kontraktore kur është e nevojshme dhe baza ligjore për ndërhyrjen e AMA-s.
Konteksti tregtar	Përshkrim i qartë dhe gjithëpërfshirës i kontekstit tregtar të mosmarrëveshjes
Përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen	Duhet të ofrohen prova gjithëpërfshirëse lidhur me përpjekjet nga të dyja palët për të zgjidhur çështjen, në veçanti për bisedimet tregtare. Kjo duhet të përmbajë njoftimin nëse mosmarrëveshja është paraqitur para ndonjë organi tjetër.
Provat e dokumentuara	Të gjitha pretendimet duhen mbështetur me dokumentacionin përkatës, në formë origjinal/kopje të noterizuar

**EMRI:**

**MBIEMRI:**

**PËRFAQËSUES I SUBJEKTIT**

**ADRESA:**

**E-MAIL:**

**NR. TELEFONI:**

**PËRSHKRUANI ANKESËN:**